



INIANA BABOÇI

MSC.

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

MSc. Iniana Baboçi është Asistent Lektore,
Koordinatorë e Programit të
Stomatologjisë

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Dentistri
- Ortodonci

EMAIL

koord.mjekesi-shnd@umb.edu.al

BIO

Dr. Iniana Baboçi ka studiuar dhe është diplomuar në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” në binjakëzim me Universitetin “Tor Vergata”, Romë; duke u drejtuar në rrugëtimin e saj nga një staf akademik me peshë internacionale.

Gjatë studimeve interesi i saj u fokusua në fushën e Ortodoncisë, duke ndjekur kështu, paralelisht me studimet një internship 2 vjeçar me një konsulent Italian të specializuar në fushën e Ortodoncisë.

Në vitin 2018 diplomohet dhe pak ditë më pas merr lejen e ushtrimit të profesionit nga Universiteti “Tor Vergata”, Romë. Nga viti 2019 deri në vitin 2021 ndjek në Bari, Itali, 2 kurse 2 vjeçare në ortodonci teoriko - praktik dhe kliniko - praktik me kohë të plotë me praktikë klinike mbi pacient në ortodoncinë interceptive, ortodoncinë e adultit dhe teknikën Straight - Wire Self-Ligating.

Në vitin 2022 ndjek një Master Shkencor të Nivelit të Dytë në Ortodonci të Avancuar në Universitetin Katolik “Sacro Cuore”, Romë, Itali. Gjithashtu ka kryer trajnime profesionale të avancuara me Nuvola - Ortodoncia Invisibile, nga të cilët është licensuar në përdorimin e teknikës së padukshme me markerina transparente, trajnime të avancuara mbi përdorimin e TAD's (pajisje ankorimi të përkohëshme skeletrike) në terapi ortodontike interceptive dhe terapi të adultit, kurse intensive mbi Biomekanikën në Ortodonci, etj; duke marrë përgatitjen e duhur për të zgjidhur rastet më të komplikuar ortodontike.

Që nga viti 2021 ushtron profesionin si Ortodonte dhe konsulente ortodontike.